



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 133/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bi-Servis” ShPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Asfalto beton*”, me nr. REF-82490-12-17-2020, me fond limit 39,733,600 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 12.01.2021, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alb Korça 2002” ShPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Biba-X” ShPK
Adresa: Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, pika inerte 50 m pranë karburant “Eurodrin”, Kavajë.

Autoriteti kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë
Adresa: Lagjja.7, Rr. “28 Nëntori”, Nr.1, Korçë.

Baza Ligjore: *Ligji Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për*

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Asfalto beton*”, me nr. REF-82490-12-17-2020, me fond limit 39,733,600 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 12.01.2021, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë 08.02.2021, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSh), përkatësisht:

1. “Bi-Servis” ShPK

31,778,872 lekë, Kualifikuar;

2. “Alb Korça 2002” ShPK	35,726,800 lekë, Kualifikuar;
3. “Biba-X” ShPK	37,100,000 lekë, Kualifikuar;
4. “Vashtemia” shpk & “Simaku” ShPK	39,336,880 lekë, Kualifikuar;

II.3. Në datën 15.02.2021, operatori ekonomik “Biba-X” ShPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik “Bi-Servis” ShPK dhe “Alb Korça 2002” ShPK, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Së pari: Operatorit Ekonomik “BI-SERVIS” ShPK në datën 07.03.2017 i është vendosur Bllokim Kuotash, pasqyruar kjo e fundit edhe në Ekstraktin Historik në të njëjtën datë me Nr. Çështjeje CN184533-03-17, Me arsye hapje çështjeje: Depozitimi i Urdhrit Nr. 164 Regj. Nr.82 Prot. Datë 02.03.2017 protokolluar nga QKB me Nr.3135 Prot, datë 02.03.2017 lëshuar nga përmbarues gjyqësor privat Jetlir Avdulaj, ku është urdhëruar: “Bllokimi i kuotave. Aktiveve të regjistruara në emër të Arben Peto deri në një urdhër të dytë në Shoqërinë “BI-SERVIS” ShPK, me Nipt K41614010T”.

Duke qenë se akoma edhe sot nuk është paraqitur asnjë vendim i dytë për heqjen e bllokimit të vendosur nga përmbaruesi as edhe pezullim të veprimeve përmbarimore kuotat apo aktivet vazhdojnë të jenë të bllokuara dhe bazuar ligjit për prokurimin publik ky operator ekonomik duhet të skualifikohet.

Së dyti: Një pikë tjetër e rëndësishme është edhe fakti që Shoqëria “BI-SERVIS” ShPK nuk plotëson furnizime të ngjashme sipas pikës 2.3 të Kapacitetit teknik në shtojcën 9 të DST. Sipas të dhënave të deklaruara, ky operator ka kryer vetëm 3 furnizime dhe asnjëra prej të cilave kanë vetëm një zë të përbashkët nga 3 zëra në preventivin e përshkruar në shtojcën 12 të DST. Konkretisht:

- Puna e Ngjashme 1 me Autoriteti Kontraktor - Bashkia Divjakë, me Objekt: Blerje Binderit për asfaltimin e rrugëve urbane, Bashkia Divjakë, me fond limit 8,333,280 lekë pa TVSh, dhe vlerë oferte 6,931,460 (Gjashtë milion e nëntëqind e e tridhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSh. Kjo kontratë përmban dy zëra në preventivin nga të cilët vetëm njëri prej tyre përbën furnizim të ngjashëm, pra vetëm emulsioni i bitumit në sasinë 4560 kg.

- Puna e Ngjashme 2 me Autoriteti Kontraktor - Bashkia Divjakë, me Objekt: Blerje Binderit për asfaltimin e rrugëve urbane, Bashkia Divjakë, me fond limit 12,6687,146 lekë pa TVSh, dhe vlerë oferte 10,200,850 (Dhjetë milion e dyqind mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSh. Kjo kontratë përmban dy zëra në preventiv nga të cilët vetëm njëri prej tyre përbën furnizim të ngjashëm, pra vetëm emulsioni i bitumit në sasinë 7331 kg.

- Puna e Ngjashme 3 me Autoriteti Kontraktor - Bashkia Divjakë, me Objekt: Blerje Binderit për asfaltimin e rrugëve urbane, Bashkia Divjakë, me fond limit 10,582,000 lekë pa TVSh, dhe vlerë oferte 8,626,750 (Dhjetë milion e dyqind mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSh. Kjo kontratë përmban dy zëra në preventiv nga të cilët vetëm njëri prej tyre përbën furnizim të ngjashëm, pra vetëm emulsioni i bitumit.

Pra nga të treja furnizimet e kryera, të shtjelluara më lart, nga Operatori “BI-SERVIS” ShPK, nuk plotëson asnjë nga kushtet e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, pasi në asnjërën nga furnizimet e mësipërme nuk përfshihen furnizimi me Asfalto-Beton (Furnizimet e kryera përbëhen nga Binder dhe Bitum). Theksojmë se po të llogarisim vlerën e përgjithshme të bitumit tek furnizimet e mëparshme nuk e arrijnë 40% të vlerës së fondit limit.

Së treti: Operatori Ekonomik "BI-SERVIS" ShPK nuk disponon Lejen Mjedisore III.1.B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, e cila kërkohet në pikën 2 paragrafi 3 i Kapacitetit teknik Disponimi i mjeteve të mëposhtme. Pra, Shoqëria "BI-SERVIS" ShPK nuk disponon një fabrikë asfalto-betoni të pajisur me leje mjedisore aktive. Ky është shkak për skualifikimin e menjëhershëm të këtij operatori pasi nuk plotëson një kriter që ju e keni vendosur! Për sa i përket largësisë së vendndodhjes së fabrikës së asfalto-betonit nga adresa e Autoritetit Kontraktor, kemi të bëjmë me një distancë prej 184 km (3 orë e 4 min), duke marrë si pikë nisje Adresën e deklaruar të Shoqërisë "BI-SERVIS" ShPK nga Autoriteti Juaj Kontraktor, e konkretisht:

Pra si më sipër, bazuar në VKM nr. 628 datë 15.07.2015 "për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe të ndërtimit të rrugëve, midis të tjerash parashikohet se: "Përzierja e prodhuar duhet të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit. E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes së përzierjes nuk lejohet të jetë më shumë se 2 orë (ne rastin konkret vendosja dhe ngjeshja do të kryhet nga vetë autoriteti kontraktor megjithatë nuk duhet të bëhet më vonë se koha e parashikuar në ligj). Kjo do të thotë se kjo distancë e tejkalon afatin prej dy orësh të parashikuar në ligj. Por edhe nëse do e llogarisim distancën nga adresa tjetër e deklaruar si ekstraktit historik të kësaj shoqërie, distanca del 162 km (2 orë e 43 min), gjithsesi jashtë kriterëve teknike.

Së katërti: Me anë të kësaj shkrese kërkohet nga ju Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë, të na vini në dispozicion kontratën e furnizimit me asfalto-beton të këtij operatori ekonomik, në qoftë se ka paraqitur një të tillë bazuar në nenin 1, pika dh) e konkretisht: dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, si edhe neni 2 të Ligjit për Prokurimin Publik: Parimet e përzgjedhjes

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve,
- b) transparencë në procedurat e prokurimit,

Kërkohet vënien në dispozicion të kontratës së furnizimit apo kontratës së qirasë të Fabrikës së Afalto-Betonit, si edhe dokumentit përkatës, pasi bazuar parimit ligjor të transparencës kërkohet të dimë nëse shoqëria qiradhënëse i plotëson kushtet e vendosura në Shtojcën 9 të DST.

Për sa më sipër dalim në përfundimin se Operatori Ekonomik "BI-SERVIS" ShPK duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë për shkak të bllokimit të kuotave të shoqërisë nga veprimet përmbartimore, mosplotësimin e furnizimit të ngjashëm, mospajisjen me Lejen Mjedisore III.1.B dhe si pasojë pamundësinë e realizimit në mënyrë të suksesshme furnizimin me Asfalto-beton sipas kriterëve teknike, pasi mospajisja me asnjë leje mjedisore dhe asnjë licensë bie ndesh edhe me parimet ligjore.

Operatori Ekonomik i kualifikuar, i renditur i dyti me ofertë "ALB KORCA 2002" ShPK duhet të skualifikohen pasi sipas informacioneve jo zyrtare, pavarësisht se është i pajisur me lejen Mjedisore III.1.B e kërkuar sipas DST, ky Operator Ekonomik disponon një fabrikë Asfalto-betoni por kjo fabrikë është jashtë funksionit. Pra fabrika e kësaj Shoqërie nuk plotëson kushtet teknike për prodhimin e zërave të Tenderit dhe nuk mund të realizojë me sukses qëllimin e kontratës me objekt: Asfalto-beton e bitum për spërkatje. [...]"

II.4. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresës nr. 159/3 prot, datë 16.02.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Biba-X” shpk duke e refuzuar atë, me arsyetimin si më poshtë:

“[...]Së pari: në lidhje me pretendimin se “Operatorit ekonomik në datën 07.03.2017 i është vendosur bllokim kuotash, pasqyruar kjo e fundit edhe në ekstraktin historik në të njëjtën datë me nr. Çështjeje Cn-184533-03-17, me arsye hapje çështjeje : depozitim i urdhrit nr. 164 regj. Nr. 82 prot. Datë 02.03.2017 protokolluar nga QKB me nr. 3135 prot, datë 02.03.2017 lëshuar nga përmbaues gjqësor privat Jetlir Avdulaj ku është urdhëruar : “Bllokimi i kuotave / aktiveve të regjistruara në emër të Arben Petto deri në një urdhër të dytë në shoqërinë “Bi Servis” ShPK me NIPT K41614010T”, zyrtari përgjegjës për shqyrtimin e ankesës pasi verifikoi dokumentet e paraqitura për procedurën e prokurimit dhe deklarimet e operatorit ekonomik të renditur në vendin e parë referon në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 45/2 i tij ku është parashikuar se: “ Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë në rastet kur: a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbauesit”. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore asnjë operatori ekonomik nuk i ndalohet të marrë pjesë në procedurat e prokurimit apo të hyjë në marrëdhënie me persona të tretë për sa kohë ky operator nuk ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbauesit. Sipas të dhënave të verifikuara nga ekstrakti i regjistrit tregtar rezulton se operatori ekonomik ka status aktiv dhe plotëson të gjitha kushtet ligjore për të hyrë në marrëdhënie me persona të tretë pavarësisht bllokimit të kuotave nga përmbauesi. I vetmi rast në interpretim të nenit 45/2 ku operatori ekonomik nuk mund të kualifikohet në procedurat e prokurimit është falimentimi dhe kur kapitalet janë në proces ekzekutimi nga përmbauesit, pra ky rast i referohet paaftësisë paguese të operatorit ekonomik, fakt i cili pasqyrohet edhe në ekstraktin e regjistrit tregtar. Po të pranohet arsyetimin që operatori ekonomik i cili ka detyrime ndaj personave të tretë, nuk mund të merrte pjesë në procedurat e prokurimit, do të çënonim qëllimin e ligjit për nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Së dyti: Në lidhje me pretendimin se shoqëria Bi servis ShPK nuk plotëson furnizimet e ngjashme në vlerën 40 % të fondit limit, zyrtari përgjegjës për shqyrtimin e ankesës pasi kreu verifikimet në dokumentacionin e paraqitur në SPE nga Shoqëria Bi servis” ShPK për plotësimin e kriterëve të kualifikimit të parashikuara nga autoriteti kontraktor arriti në konkluzionin se: Kjo shoqëri ka paraqitur një marrëveshje nënkontraktimi me shoqërinë Alb Building ShPK, sipas së cilës nënkontraktori shoqëria Bi Servis merr përsipër furnizimin e prodhimit dhe furnizimit me asfalt për ByPassin FIER. Nga faturat dhe situacionet e, paraqitura rezulton se shoqëria të ketë kryer furnizime të ngjashme me vlerë rreth 33,000,000 lekë pa TVSh dhe për këtë arsye plotëson kërkesat e AK për realizimin e furnizimeve të ngjashme brenda tre viteve të fundit me vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit apo 15,893,440 lekë pa TVSh.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Së treti: Në lidhje me pretendimin se kjo shoqëri nuk disponon lejen mjedisore III.1.b lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit dhe për rrjedhojë kjo shoqëri nuk ka fabrikë asfalti të pajisur me leje mjedisi aktive si dhe për sa i përket largësisë duke qenë se shoqëria e ka pikën e prodhimit 162 km nga objekti dhe del jashtë kriterëve teknike, nga verifikimi i kryer nga zyrtari përgjegjës për

shqyrtimin e ankesës rezultoi se: Operatori ekonomik për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik ka paraqitur kontratën nr. 1979 rep. 885 kol. të datës 17.09.2020 të lidhur pranë noteres Mimoza Sadushaj për marrjen me qira të pajisjes së fabrikës së asfalto-betonit për një afat 1 vjeçar me të drejtë ripërtëritje, fabrikë në pronësi të subjektit Bi Investment. Bashkëlidhur kësaj kontrate është paraqitur edhe vërtetimi hipotekor nga ZVRPP Lushnjë për pasurinë së bashku me hartën treguese. Bashkëlidhur janë paraqitur edhe faturat e zhdoganimit si dhe leja mjedisore nga Ministria e mjedisit dhe qendra kombëtare e licensimit. Autoriteti kontraktor në DST ka kërkuar:

Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	PRONESIA
Mjet Transporti , kamion	copë 1	Në pronësi ose me qira
Fabrikë asfaltobetonit	copë 1	Në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi të nënshkruar para noterit, për furnizimin.

-Për mjetin e transportit në rast se është në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit. Kur mjeti është me qira duhet të paraqitet : kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. - Për Fabrikën e Asfalto-betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten: dokumente që vërtetojnë pronësinë (duhet të paraqitet certifikatë pronësie, plan vendosje dhe/ose faturë tatimore dhe/ose faturë zhdoganimi) dhe leja mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Kur Fabrika e Asfalto-betonit është me qira duhet të paraqitet: Kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë (duhet të paraqitet certifikatë pronësie, plan vendosje dhe/ose faturë tatimore dhe/ose fature zhdoganimi) dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit ose leja mjedisore të lëshuara nga Ministria e Mjedisit.)

Në rast se nuk është në pronësi apo me qira: duhet të paraqitet kontrata e furnizimit nënshkruar para noterit me prodhuesin ku të jetë i përcaktuar:

a. Furnizimi i vazhdueshëm dhe sipas kërkesës;

b. Sasia dhe afati i përfundimit të kontratës

Operatori ekonomik, Shoqëria “BI SERVIS” ShPK ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për disponimin e makinerive dhe fabrikës së asfalto-betonit, kurse për sa i përket cilësisë së asfaltit, prodhimit të tij dhe furnizimit në kohë operatorët ekonomikë e plotëson përmes shtojcës nr. 6 me deklarimin për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”. Cilësia e Asfaltit, rregullat e furnizimit dhe specifikimet janë pjesë përbërëse e kontratës dhe nuk mund të jenë arsye për skualifikimin në këtë fazë të procedurës. Autoriteti kontraktor i udhëhequr nga parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit nuk mund të paragjykojë operatorin ekonomik në lidhje me mundësinë e zbatimit dhe realizimit të kontratës objekt i prokurimit. Për këtë arsye referuar parashikimeve të legjislacionit për prokurimet në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit

nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku është parashikuar se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese” si dhe në nenin 33, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”, për sa kohë operatori ekonomik ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK, oferta e tij është e kualifikueshme sipas të gjitha kriterëve ligjore.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimin se operatori ekonomik “Alb Korça 2002” ShPK duhet të skualifikohet pasi sipas informacioneve jozyrtare, pavarësisht se është i pajisur me lejen mjedisore III.1.b e kërkuar në DST, ky operator ekonomik disponon një fabrikë asfalto-betoni por kjo fabrikë është jashtë funksionit dhe shoqëria e ka të pamundur të realizojë objektin e prokurimit zyrtari përgjegjës për shqyrtimin e ankesës vendosi të mos shqyrtojë pretendimet e shoqërisë ankimuese për arsye se:

1. Nuk janë të mbështetura në prova shkresore.

2. Pozita juridike e operatorit ekonomik në këtë procedurë nuk do të ndryshonte edhe sikur zyrtari përgjegjës të pranonte ankesën në lidhje me pretendimet e ngritura për shoqërinë Alb Korça 2002 ShPK

Përfundimisht, zyrtari përgjegjës për shqyrtimin e ankesës vendosi të mos pranojë ankesën e shoqërisë BIBA X ShPK për procedurën e prokurimit me objekt: “Asfalto-beton”. [...]

II.5. Në datën 26.02.2021, operatori ekonomik ankimues “Biba-X” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, si dhe duke shtuar pretendimin si më poshtë vijon:

“[...]Kontrata e qirasë e vënë në dispozicion nga AK me nr. repertori 1979 nr. koleksioni 885 nga shoqëria BI Servis & BI INVESTMENTS datë 17.09.2020 Neni 2 (AFATI I KONTRATËS) thuhet se: “Palët bien dakord që kjo kontratë të lidhet për një afat 1 (një vjeçar) afat i cili fillon më datë 16.09.2020 deri më 16.09.2021, me të drejtë ripërtëritje”.

Në DST fq 10 pika 6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin është 12 muaj duke filluar nga data e lidhjes së saj. Pra shoqëria “BI-Servis” nuk plotëson kriterin mbi disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve për realizimin e kësaj kontrate pasi kontrata e qirasë mbaron 6 muaj përpara përfundimit të realizimit të kontratës.[...]”

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 242/2 prot., datë 10.03.2021, protokolluar me tonën në datën 11.03.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Biba-X” ShPK për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alb Korça 2002” ShPK me argumentin: “*Operatori Ekonomik i kualifikuar, i renditur i dyti me ofertë “ALB KORÇA 2002” ShPK duhet të skualifikohen pasi sipas informacioneve jozyrtare, pavarësisht se është i pajisur me lejen Mjedisore III.1.B e kërkuar sipas DST, ky Operator Ekonomik disponon një fabrikë Asfalto-betoni por kjo fabrikë është jashtë funksionit. Pra fabrika e kësaj Shoqërie nuk plotëson kushtet teknike për prodhimin e zërave të Tenderit dhe nuk mund të realizojë me sukses qëllimin e kontratës me objekt: Asfalto-beton e bitum për spërkatje.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.2 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si më poshtë vijon:

“Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	PRONËSIA
Mjet Transporti , kamion	copë 1	Në pronësi ose me qira
Fabrike asfalto-betoni	copë 1	Në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi të nënshkruar para noterit, për furnizimin.

-Për mjetin e transportit në rast se është në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.

Kur mjeti është me qira duhet të paraqitet : kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

- Për Fabrikën e Asfaltobetonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten: dokumente që vërtetojnë pronësinë (duhet të paraqitet certifikatë pronësie, planvendosje dhe/ose faturë tatimore dhe/ose faturë zhdoganimi) dhe leja mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Kur Fabrika e Asfaltobetonit është me qira duhet të paraqitet : Kontrata e qirase e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë (duhet të paraqitet certifikatë pronësie, planvendosje dhe/ose faturë tatimore dhe/ose faturë zhdoganimi) dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Në rast se nuk është në pronësi apo me qira: duhet të paraqitet kontrata e furnizimit nënshkruar para noterit me prodhuesin ku të jetë i përcaktuar :

*furnizimi i vazhdueshëm dhe sipas kërkesës ,
a. sasia dhe afati i përfundimit të kontratës.”*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, rezulton se operatori ekonomik “Alb Korça 2002” ShPK, në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë shit-blerjeje nr.3762rep, nr.1235kol., datë 03.07.2017, me shitës shoqëria “Al-Road” ShA dhe blerës shoqëria “Alb Korça 2002” ShPK, me objekt shit-blerja e pajisjeve dhe makinerive për përgatitjen dhe prodhimin e asfalto-betonit, shoqëruar me fatura tatimore shitjeje, deklarata doganore, certifikatë pronësie, planvendosje e strukturës miratuar nga Bashkia Maliq dhe fotografi;
- Leje mjedisore III.1.B, shoqëruar me akt-miratimin nr.4700prot., datë 01.07.2020 të miratuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se zotërojnë makineritë dhe pajisjet e duhura për zbatimin me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Alb Korça 2002” ShPK, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, Komisioni vëren se ky i fundit ka paraqitur kontratë shit-blerjeje nr.3762rep, nr.1235kol., datë 03.07.2017, me shitës shoqëria “Al-Road” ShA dhe blerës shoqëria “Alb Korça 2002” ShPK, me objekt shit-blerja e pajisjeve dhe makinerive për përgatitjen dhe prodhimin e asfalto-betonit, shoqëruar me fatura tatimore shitjeje, deklarata doganore, certifikatë pronësie, planvendosje e strukturës miratuar nga Bashkia Maliq dhe fotografi si dhe Leje mjedisore III.1.B, shoqëruar me akt-miratimin nr.4700 prot., datë 01.07.2020 të miratuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Komisioni gjykon se me anë të këtij dokumentacioni, operatori ekonomik “Alb Korça 2002” ShPK, arrin të provojë se disponon fabrikën e asfalto-betonit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në

dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se fabrika e asfalto-betonit nuk është funksionale, Komisioni gjykon se ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë argument se nga se vjen mosfunksionaliteti i fabrikës apo provë konkrete për të mbështetur pretendimet e tij. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtpërdrejtë i furnizimit të kërkuar, është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata. 2. Ofertuesit ose kandidatit mund t’i kërkohej të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni. 3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”. Pra autoriteti kontraktor, si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e furnizimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Biba-X” ShPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Biba-X” ShPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bi-Servis” ShPK, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi operatori ekonomik “Alb Korça 2002” ShPK përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Bi-Servis” ShPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Biba-X” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Asfalto beton*”, me nr. REF-82490-12-17-2020, me fond limit 39,733,600 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 12.01.2021, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 355 Protokoli Datë 26.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri